VENDIM
Nr. 412, datë 10.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (Lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C" të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "a", sipas ndryshimit bashkëlidhur këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT
(LISTA E OKB-së)

C) LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da'esh) dhe AL-Qaida";

1. FRITZ; MARTIN; GELOWICZ
2. DIEMAN; ABDULKADIR IZZAT
3. ATA; ABDOULAZIZ; RASHID

Shënim: Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është renditur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.